

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagon drejtuesi i ISHTI pas kronikës së “Fiks Fare”: Fjalët e mia u shkëputën nga konteksti, publikoni vi deon e plotë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/reagon-drejtuesi-i-ishti-pas-kronikes-se-fiks-fare-fjalet-e-mia-u-shkep-uten-nga-konteksti-publikoni-videon-e-plote/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 12:12:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 12:10:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a436027ba63c876a14e27ec09beed1094c065b743e30153ab84fd34b01b13726
TEKSTI	5bcb4cd37932b2b1dc275e00c1091920ecec429a2d89c97b9a5107d537a8130c
PAMJA	54407d931bf6d125ef01332ef295a1e25706e26d38a625483cbaede2a44b2d2c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	538a4c6c5fced40f20f14fd3bd62b732273971618b4090a455881c929bd08d0d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5a00511fec2dd72c79527889eef91c0b757bfc2cb84c819aee6ec0978e94e200
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/538a4c6c5fced40f20f14fd3bd62b732273971618b4090a455881c929bd08d0d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Reagon drejtuesi i ISHTI pas kronikës së "Fiks Fare": Fjalët e mia u shkëputën nga konteksti, publikoni videon e plotë

KRYESORE

Demo

Reagon drejtuesi i ISHTI pas kronikës së "Fiks Fare": Fjalët e mia u shkëputën nga konteksti, publikoni videon e plotë

SEPTEMBER 29, 2026



Pas kronikës së transmetuar në emisionin "Fiks Fare" në Top Channel, ku u publikuan pamje nga një bisedë e regjistruar mes drejtuesit të ISHTI-së dhe Rudina Demnerit, ka reaguari Sokol Zaimi, duke i cilësuar të dhënat e transmetuara si "disinformuese".

Në reagimin e tij, Zaimi sqaron rrethanat e takimit me Demnerin, duke pretenduar se disa nga deklaratat e tij janë shkëputur nga konteksti dhe kanë deformuar kuptimin e bisedës. Sokol Zaimi mohon çdo lidhje me deklaratave të tij dhe një kërkesë për punësim, ndërsa kërkon nga Top Channel publikimin e videos së plotë të takimit.

Reagim ndaj kronikes se Fiks Fare:

Ndoqa me shqetësim kronikën disinformuese të transmetuar mbrëmjen e djeshme në emisionin "Fiks Fare" në Top Channel.

Sqaroj se, në datën 22 shtator, në prani edhe të Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore të institucionit, kam pritur në takim Rudina Demneri, e njohur për publikun si Paloma, e cila është interesuar për punësimin e një personi të saj të afërm. E kam informuar qartësisht, në prezencë të Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore të institucionit rrethës, se nevojat e institucionit janë kryesisht për inxhinierë elektrikë dhe se çdo person i interesuar për punësim duhet të ndjekë një procedurë ligjore, sipas hapave dhe kriterëve të përcaktuara.

Biseda rreth Znj. Balluku u provokua qëllimisht nga Demneri, e cila ju referua si mikeshë të mirë, të cilën e takon shpesh dhe për të cilën gëzon vlerësim.

Fjalja ime e përfshirë në kronikë është shkëputur qëllimisht nga konteksti i bisedës dhe është paraqitur në një mënyrë që deformon kuptimin e asaj që kam thënë. Ajo nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e bërë nga znj. Demneri për punësim dhe as me ndonjë proces tjetër institucional.

Qëndrimi im ka qenë dhe mbetet i qartë: Unë besoj se znj. Balluku, në përfundim të betejës së saj ligjore, do të dalë e pafajshme, pasi, për aq sa e kam njohur në marrëdhëniet tona të punës, ajo ka qenë e drejtë dhe korrekte. Ky është një qëndrim imi personal dhe nuk ka lidhje me detyrën apo pozicionin tim institucional.

Edhe referimi im ndaj znj. Balluku me fjalën "shefe" është pjesë e respektit personal që unë kam për të dhe nuk lidhet në asnjë mënyrë me pozicionin tim aktual si drejtues i ISHTI.

Postimet e reja

Reagon drejtuesi i ISHTI pas kronikës së "Fiks...

SEPTEMBER 29, 2026

Instalimi i POS-eve për pagesa elektronike,...

SEPTEMBER 29, 2026

Operacion antidrogë në Qafështamë/ Dëgjohen t...

SEPTEMBER 29, 2026

Kombinati me një shkollë të transformuar, "Shyqyr...

SEPTEMBER 29, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

Është e papranueshme që fjalët e mia të priten, të përzgjidhen dhe të vendosen në një kontekst të ndryshëm nga ai në të cilin janë thënë, duke i dhënë publikut një mesazh që unë nuk e kam thënë dhe nuk e kam nënkuptuar.

Prerjet dhe përzgjedhjet e fjalëve jashtë kontekstit janë të qëllimshme dhe, sipas vlerësimit tim, janë pjesë e një sulmi të koordinuar të televizionit Top Channel ndaj meje. Arsyet e këtij sulmi nuk i di dhe nuk i vlerësoj dot, por një gjë është e qartë: Nuk do të lejoj që fjalët e mia të deformohen dhe të përdoren për të krijuar një realitet të rremë para opinionit publik.

Ndaj, i bëj thirrje Top Channel të transmetojë videon e plotë të regjistruar në menyrë të fshehtë nga Demneri.

Trishtim tek shoh se si televizioni dikur më i ndjekur nga shqiptarët, është shndërruar në një gjobëvënës.

Belinda Balluku deklarata drejtuesi i institucionit drejtuesi i ISHTI fiks fare institucion ISHTI kronika e Fiks Fare kronikë televizive media Paloma pretendime për disinformim punësim reagim reagim ndaj Top Channel Rudina demneri shqipëri top channel video e plotë

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.